



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbil Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 13.06.2025 VI-020-360
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Ferizajt	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e kuvendit të komunës në vijim:

Vendim 01.Nr. 55 për shpalljen interes të përgjithshëm të ngastrave kadastrale: 3523-1 Z.K pronë private, me qellim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 188-1 Z.K Talinovic i Jerlive pronë e komunës së Ferizajt

I miratuar më datë: 30.05.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.06.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se:

1. Akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi;
2. Pezullohet zbatimi i Vendimit 01.Nr. 55 për shpalljen interes të përgjithshëm të ngastrave kadastrale: 3523-1 Z.K pronë private, me qellim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 188-1 Z.K Talinovc i Jerlive pronë e komunës së Ferizajt

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2025, ka miratuar Vendimin 01.Nr. 55 për shpalljen interes të përgjithshëm të ngastrave kadastrale: 3523-1 Z.K pronë private, me qellim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 188-1 Z.K Talinovc i Jerlive pronë e komunës së Ferizajt.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt, është bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008", në nenin 51 pika 2.9 e Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, në nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010, në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, paragrafin 5 të nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, shpallja e interesit behet me qellim të këmbimit të pronave për ti ofruar qasja më të lehtë banorëve për kyqjen në rrugën "Luigj Gurakuqi".

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Ferizajt me datë 30.05.2025, dhe është miratuar më 18 vota për, 13 kundër dhe 0 abstenime.

Sipas nenit 10 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës: *"Kuvendi i Komunës dhe ekzekutivi i komunës nuk mund të merr asnjë vendim lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nga dita kur Presidenti shpall zgjedhjet lokale"*, po ashtu edhe neni 33, paragrafi 1, i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, përcakton se: *"Kuvendi i Komunës dhe Ekzekutivi i Komunës nuk mund të merr asnjë vendim dhe të gjitha procedurat të cilat zhvillohen lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës pezullohen nga dita kur Presidenti shpall zgjedhjet lokale deri në konstituimin e organeve të komunës"*, andaj pezullohen të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës pasi që me Vendimin Nr. 22/2025 të datës 09.06.2025 Presidentja e Republikës së Kosovës ka shpallur zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës të cilat do të mbahen me datë 12.10.2025.

Komuna pas konstituimit të organeve të komunës të dalura nga zgjedhjet lokale që do të mbahen me datë 12.10.2025, mund të vazhdoj me procedurën e këmbimit të pronës komunale.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Agim Aliu , gradonačelnik opštine Uroševac Xhavit Zariqi , predsedavajući Skupštine opštine Uroševac	
Cc::	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administrarciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi , ministar MALS-a, Jeton Qela , generalni sekretar MALS-a,	
Od:	Erbilin Hetemi , rukovodilac Pravnog odeljenja /MALS	Dana, 13.06.2025 VI-020-360
Odgovorni službenici:		
1.Službenik/ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa , rukovodilac odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika	
2.Službenik/ca za izradu pravne ocene	Vjosa Ahmetaj , viša službenica za razmatranje zakonitosti akata opštine	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Uroševac	
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani/a gradonačelnice/e,
Poštovani/a predsedavajući/a,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 01. br. 55 o proglašenju od opšteg interesa katastarskih parcela: 3523-1 K.Z. privatna svojina, u cilju razmene sa delom katastarske parcele 188-1 K.Z Talinovci i Jerlive, imovina opštine Uroševac
Usvojena dana, 30.05.2025.god
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 05.06.2025.god

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da:

1. Opštinski akt je proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.
2. Obustavlja se sprovođenje Odluke 01. br. 55 o proglašenju od opšteg interesa katastarskih parcela: 3523-1 K.Z. privatna svojina, u cilju razmene sa delom katastarske parcele 188-1 K.Z Talinovci i Jerlive, imovina opštine Uroševac

Obrazloženje

Skupština Opštine Uroševac je na sednici održanoj dana, 30.05.2025.godine, odobrila Odluku 01. br. 55 o proglašenju od opšteg interesa katastarskih parcela: 3523-1 K.Z. privatna svojina, u cilju razmene sa delom katastarske parcele 188-1 K.Z Talinovci i Jerlive, imovina opštine Uroševac.

MALS, konstatuje da je odluka doneta od strane Skupštine opštine Uroševac zasnovana na članu 12 Zakona 03/L-040 o lokalnoj samoupravi „Službeni list Republike Kosovo br. 28/2008“, na članu 51, tačka 2.9 Statuta opštine 01. br. 50 od 28.06.2013. godine, na članu 4. Zakona o eksproprijaciji nepokretne imovine br. 03/L-139 sa izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-205 od 28.10.2010. godine, na članu 24 stav 4. Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, stav 5 člana 29 Uredbe (VRK) br. 09/2020, o utvrđivanju postupka za davanje na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, objava o interesu se daje sa ciljem razmene imovine kako bi se stanovnicima omogućio lakši pristup priključku na ulicu „Luigj Gurakuqi“.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Uroševac dana, 30.05.2025. godine, sa 18 glasa za, 13 protiv i 0 uzdržanih.

Prema članu 10. Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine: „*Skupština opštine i izvršna vlast opštine ne mogu donositi nikakve odluke u vezi sa davanjem na korišćenje i razmenom nepokretne imovine opštine od dana kada predsednik raspiše lokalne izbore*“, takođe i član 33. stav 1. Uredbe (VRK) br. 09/2020 o određivanju postupaka za dodelu i razmenu nepokretne imovine opštine, predviđa da: „*Skupština opštine i izvršna vlast opštine ne mogu donositi nikakve odluke i svi postupci koji se sprovode u vezi sa davanjem na korišćenje i razmenom nepokretne imovine opštine obustavljaju se od dana kada predsednik raspiše lokalne izbore do konstituisanja opštinskih organa*“, stoga se sve radnje vezane za davanje na korišćenje i razmenu imovine obustavljaju, jer je Odlukom br. 22/2025 od 09.06.2025. godine, predsednica Republike Kosovo raspisala lokalne izbore u Republici Kosovo kojiće se održati 12.10.2025. godine.

Opština, nakon konstituisanja opštinskih tela na osnovu lokalnih izbora koji će se održati 12.10.2025. godine, može nastaviti sa postupkom razmene opštinske imovine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.